

AKTI I THEMELIT DHE STATUSI
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar
“LAB FOOD CONSULTING ” sh.p.k
Forma e Shoqërisë

Neni 1

Sot, më datë 07.03.2024 ne themeluesit, Alvi Bardhi dhe Ledio Baze, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“LAB FOOD CONSULTING ” sh.p.k.** Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Z. **Alvi Bardhi**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 28.10.1984 i lindur në Fier, banuese në Tiranë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. ID I41028099A.
2. Z. **Ledio Baze**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 09.10.1991 i lindur në Përmet, banuese në Tiranë madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e kartës së Identitetit me nr ID J11009027M

Qendra e Shoqërisë

Neni 2

Selia e Shoqërisë **“LAB FOOD CONSULTING ” sh.p.k.** ndodhet ne adresën: Kashar – Tirane Zona Kad. 3866 Pas.301/147, Astir - Tirane. Shoqëria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Neni 4

- Konsulencë në fushën e sigurisë ushqimore .Hartimi, mirëmbajtja e dokumentacionit në lidhje me sistemin e vetëkontrollit HACCP, krijimi I sistemit të gjurmueshmërisë , formulim etikete ushqimore, konsulencë në aplikimet për liçensim, konsulencë për lejet higjieno sanitare, konsulencë në lidhje me paketën higjienike, konsulencë për procedurat e import – exportit, ku përfshihet dhe certifikata e sistemit Trace. Konsulencë për ankimimin e masave administrative, konsulencë mbi trajnimin e stafit në lidhje me sigurinë ushqimore Mbeshtetje teknike në industrinë ushqimore. Çdo aktivitet tjetër I lejuar në legjislacionin shqipëtarë.

Neni 5



Kjo shoqëri mund të ndryshojë emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Kapitali i shoqërisë Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë .

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme që nënkuptohet i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 000 lekë. Kjo kuotë i përket ortakëve si më poshtë:

1. **Alvi Bardhi** zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Ledio Baze** zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50 000 lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakëve.

Drejtimi dhe administrimi Neni 7

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që permban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 8

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tij nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetem pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.


Neni 9

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve si dhe emrat e ortakëve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 10

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtë kontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Kompetencat e ortakëve



Neni 11

Për mënyrën e drejtimin dhe ushtrimin të aktivitetit të shoqërisë, ortaku shprehet me vendime për gjithçka që është në kompetencat e tyre të përshkruara si më poshtë:

Kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në statut.

Kanë të drejtë të miratojnë bilancin e shoqërisë dhe të bëjnë ndarjen e fitimit.

Ata emerojnë administratorët, zëvendësit, ekspertet dhe revizoret kontabël.

Ata aprovojnë çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencat e tyre

Miratojnë zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit

Përcaktojnë shpërblimin për administratorin, ekspertet, revizoret kontabël.

Bëjnë transferimin e kuotave të të tretët.

Bëjnë lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.

Realizojnë blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë.

Kanë të drejtë të bëjnë modifikimin e kontratës së shoqërisë, etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakëve, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

Administrimi

Neni 13

Administratori i shoqërisë është caktuar z. **Ledio Baze**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes 09.10.1991 i lindur në Përmet, banuese në Tiranë madhorë me zotesi të plote juridike për të vepruar, mbajtës e kartës së Identitetit me nr ID J11009027M.


Afati i mandatit është 5 (pesë) vjet.

Neni 14

Administratori mund të emerojë një ose më shumë administrator të deleguar ose perfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të vecanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 15

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe Statut që i takojnë ortakëve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.



Marrëdhëniet e punës

Neni 16

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendëshme të saj. Të punësuarit duhet të pergjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Ekspertet ose revizoret kontabë

Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qendrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortakët caktojnë dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

Viti financiar, bilanci vjetor, shpërndarja e fitimeve

Neni 19

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit. Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhen brenda 6 muajve që nga fundi i vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet

Neni 20


Veprimtaria ekonomike do të mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me sipër paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 21

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortakët vendosin brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtëzakonshme të shoqërisë.

Shpërndarja dhe likuidimi i shoqërisë

Neni 22



Në rast se shoqëria shpërndahet për cdo lloj arsye asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme për çregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

**Librat e shoqërisë
Neni 23**

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:

1-libri i ortakëve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve të administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve të ekspertëve ose revizoreve kontabël

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vulosur.

**Dispozita te pergjitheshme
Neni 24**

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9922, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë sic është nxjerrë ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

**Ortakët e
Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar**

“LAB FOOD CONSULTING ” sh.p.k.

ALVI BARDHI

LEDIO BAZE

Tiranë më 07/03/2024

